REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 316/20
Datë/Datum. 29.05.2020
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Majlinda Bedrolli	***Data e autorizimit të ekspertit 22.05.2020***	***Data e dorëzimit të raportit 29.05.2020***	***Nr. i lëndës: 316/20***

1.BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 19.05.2020, OE NTGI "Grafo Loni"-Prishtinë ka parashtruar ankesë me nr: **316/20,** kundër propozimit për dhënie të kontratës ku është rekoëmanduar për kontratë OE "Signal Tech" SH.P.K,-Gjakovë lidhur me aktivitetin e prokurimit: ***"Furnizim evidentimi shënim si dhe vendosja e shenjave turistike në Komunë Skenderaj",*** me nr. të prokurimit***:643-20-1207-1-3-6***, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna e Skenderaj.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurën e kuotimit të çmimit, lloji i kontratës: kontratë me vlerë të vogël - furnizim, vlera e parashikuar e kontratës: 5,000.00€.

Datat për fazat e ndryshme të procedurës së tenderit deri në ankesë janë si në vijim: Data e njoftimit për kontratë 07.04.2020, data e hapjes së ofertës 14.04.2020, data e njoftimit për dhënien e kontratës 13.05.2020.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

2. PRETENDIMET ANKIMORE

OE pretendon se AK, nuk ka respektuar dispozitat e LPP-se dhe ate
Neni 7, 59 dhe 60, të LPP-së.
Deklarate detale:
Ky aktivitet i prokurimit ka të bëjë me tenderin "Furnizim evidentimi shënim si dhe vendosja e shenjave

turistike në Komunë Skenderaj".

Me datë 07.04.2020 është publikuar njoftimit për kontratë.
Me datë 14.04.2020 është bërë hapja publike e ofertave.
Autoriteti kontraktues me datë 13.05.2020 e publikon njoftimin për dhënie të kontratës duke e rekomanduar për kontratë OE "Signal Tech" SH.P.K,-Gjakovë .
Me datë 13.05.2020 AK njofton me letër standarde për tenderusin e eliminuar OE ankues.
Me datë 14.05.2020, OE ankues "NTGI Grafo Loni"-Prishtinë ka parashtruar kërkesë për ri-vlerësim pranë autoritetit kontraktues.
Me datë 18.05.2020, kërkesa për ri-vlerësim e OE ankues "NTGI Grafo Loni"-Prishtinë është refuzuar si e pa bazuar nga ana e autoriteti kontraktues.

3. FAKTET E RASTIT TË RËNDËSISHME PËR PRETENDIMET

III.4.Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale		Kapaciteti teknik dhe profesional: Kapaciteti teknik dhe profesional: Kërkesa 1.OE duhet të ofroj dëshmi se ka përfunduar me sukses së paku një kontratë për furnizime të ngjajshme në tri vitet të fundit nga data e publikimit të këtij njoftimi për kontratë.	Dëshmia e kërkuar dokumentare Dëshmia 1. Lista e kontratave realizuara (përfunduara) të natyrës ngjajshme në tri vitet të fundit nga data e publikimit të njoftimi për kontratë të bashkëngjitura me kopje të referencave apo certifikatat apo raportet të pranimit.

4. RAPORTI I KOMISIONIT VLERËSUES

Duke u bazuar në raportin e vlerësimit, komisioni vlerësues ka konstatuar si në vijim:

Komuna e Skenderaj shpërblen me kontratë OE "Signal Tech" SH.P.K,-Gjakovë, në vlerë totale prej 3,928.31€.

5. VENDIMET E MËPARSHME LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

NA

6. ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

NA

7. VLERËSIMI I PRETENDIMEVE TË NDRYSHME TË ANKESËS

Sqarim hyrës: Komuna e Skenderaj gjatë këtij aktiviteti të prokurimit ka zbatuar procedurën e kuotimit të

çmimit, lloji i kontratës është kontratë me vlerë të vogël - furnizim.

Pretendimet ankimore kanë të bëjnë kundër propozimit për dhënie të kontratës. Kundër të njëjtit propozim parashtruesi i ankesës me datën 14.05.2020 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim tek AK- Komuna e Skenderajt, me pretendimet e njëjta ankimore si në OSHP, përderisa AK me datën 18.05.2020 përmes vendimit ka refuzuar kërkesën si të pa bazuar të OE NTGI "Grafo Loni"-Prishtinë.

Neni 111, paragrafi 5, i LPP-se, shprehimisht potencon: *"Nëse OSHP konstaton se ankesa është parashtruar me kohë dhe i plotëson kushtet sipas paragrafit 1. të këtij neni OSHP menjëherë do të (i)* ***caktojë një ekspert për shqyrtim sipas nenit 113*** *dhe (ii) formojë një panel shqyrtues për t'i shqyrtuar pretendimet e bëra në ankesë.*

Lidhur me pretendimin e parë të OE ankues NTGI "Grafo Loni"-Prishtinë se autoriteti kontraktues ka shkelur nenin 7 të LPP-së.

III.4.Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale			Kapaciteti teknik dhe profesional: Kapaciteti teknik dhe profesional: Kërkesa 1.OE duhet të ofroj dëshmi se ka përfunduar me sukses së paku një kontratë për furnizime të ngjajshme në tri vitet të fundit nga data e publikimit të këtij njoftimi për kontratë.	Dëshmia e kërkuar dokumentare Dëshmia 1. Lista e kontratave realizuara (përfunduara) të natyrës ngjajshme në tri vitet të fundit nga data e publikimit të njoftimi për kontratë të bashkëngjitura me kopje të referencave apo certifikatat apo raportet të pranimit.

1. Ne si operator ekonomik na është kërkuar nëpërmjet një letre standarde ti dërgojmë dëshmitë për furnizim të ngjashme dhe me datën 29.04.2020 kemi dërguar dëshmi që kompania jonë ka eksperiencë të mjaftueshme për të përfunduar këtë kontrate 100% sipas kërkesave të autoritetit kontraktues. OE ankues vazhdon të pretendoj se AK ka shkelur nenin 7 të LPP-së (Barazia në Trajtim /Jo-Diskriminim) duke hedhur poshtë dëshmitë tona që vetëm në kontratën me Ministrin e Tregtis mbi 70 artikuj të ndryshëm në shtyp madje për tu bërë me të lehet punën e komisionit i kemi hijezuar artikujt e ngjashëm. "Askund në dosjen nuk shkruan furnizime të njëjta por të ngjashme por të ngjashme''

Me këtë AK ka shkelur nenin 7 të LPP-së duke e shpallur fitues një kompani me të shtrenjtë se ne duke e dëmtuar buxhetin e shtetit me 303.31 euro.

Përgjigje në pretendimin e parë:

Lidhur me pretendimin e OE ankues N.T.G.I. "GRAFO-LONI" që ka të bëjë me mos pranimin e referencave nga AK, eksperti shqyrtues sqaron se OE ankues ka bashkangjitur referencën e lëshuar nga autoriteti kontraktues "Ministria e Shëndetësisë" të datës 30.01.2020, ku përmes kësaj reference dëshmohet se OE N.T.G.I. "GRAFO-LONI" me seli në Prishtinë ka qenë kontraktues i AK "Ministria e Shëndetësisë" për "Furnizimin me dokumentat shëndetësor, recetat" me numër të prokurimit 206-15-036-111, kontratë kornizë tre vjeçare, e nënshkruar me datë 20.07.2016 dhe me datë të skadimit 19.07.2019. Pra, kjo referencë dëshmon se vlera e furnizimeve për vitin 2017 ka qenë në shumë prej 68,608.41 euro, për vitin 2018 vlera e furnizimit ka qenë në vlerë prej 87,293.74 euro dhe për vitin 2019 vlera e furnizimeve ka qenë 90,132.82 euro. Pastaj, OE ankues ka bashkangjitur referencën e AK "Këshilli Prokurorial i Kosovës" të datës 26.06.2018 për kontratën me titull "Furnizim me material shtypës për nevojat e Këshillit Prokurorial të Kosovës" me numër të prokurimit PSH250-016-011-121. Po ashtu, OE ankues i ka bashkangjitur edhe referencën e AK "Ministria e Tregtisë dhe Industrisë" të datës 29.01.2020 me titull "Shërbime të dizajnit dhe shtypjes së materialeve të ndryshme" me numër të prokurimit MTI204-18-1664/018-221 me vlerë të kontratës në shumë prej 32,022.25 euro. Lidhur me këtë referencë, OE ankues ka bashkangjitur edhe dosjen e tenderit që ka të bëjë me referencën e lëshuar nga Ministria e Tregëtisë dhe Industrisë. Gjithashtu, OE ankues ka bashkangjitur edhe referencën e lëshuar nga AK "Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë" të datës 29.01.2020 për kontratën me titull "Furnizim me material të shypur me numër identifikues" me numër të prokurimit 40800/17/029/136 me vlerë të realizuar të kontratës në shumë prej 8,815.00 euro për vitin 2017 dhe vitin 2018. OE ankues ka bashkangjitur edhe disa referenca, ku disa prej tyre është e pamundur të lexohen për shkak të kopjimit jo të mirë.

Eksperti Shqyrtues sqaron se autoriteti kontraktues në dosjen e tenderit tek pika III.4 "Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale" ka kërkuar: Kërkesa 1.OE duhet të ofroj dëshmi se ka përfunduar me sukses së paku një kontratë për furnizime të ngjajshme në tri vitet të fundit nga data e publikimit të këtij njoftimi për kontratë: Dëshmia e kërkuar dokumentare Dëshmia 1. Lista e kontratave realizuara (përfunduara) të natyrës ngjajshme në tri vitet të fundit nga data e publikimit të njoftimi për kontratë të bashkëngjitura me kopje të referencave apo certifikatat apo raportet të pranimit.

Lidhur me këtë kërkesë të AK-së, eksperti shqyrtues vlerëson se kjo kërkesë e dosjes së tenderit të AK-së nuk është përmbushur nga OE ankues për shkak se këto referenca kanë të bëjnë me furnizim të natyrës së materialeve të shtypura (printuara) kryesisht për nevoja të zyreve dhe jo evidentimi shënim si dhe vendosja e shenjave turistike siç ka kërkuar AK. Rrjedhimisht, OE ankues nuk ka referenca të ngjajshme. Andaj, pretendimi i OE ankues është i pa bazuar.

Lidhur me pretendimin e dytë të OE ankues NTGI "Grafo Loni" - Prishtinë se autoriteti kontraktues ka shkelur nenin 59 të LPP-së (Ekzaminimi, Vlerësim dhe Krahasimi i Tenderëve) pasi që nuk e ka vlerësuar tenderin si duhet duke shpallur fitues një operator ekonomik me të shtrenjtë. Ne si OE jemi telefonuar nga AK duke na u kërkuar sqarim nuk kemi dërguar dëshmi sa duhet por pas sqarimit tonë që të gjitha dëshmitë i kemi në platformën e e-prokurimit edhe se i përmbushim kriteret e vendosura nga AK zyrtari përgjegjës i prokurimit na ka konfirmuar se do të rishikoj edhe një herë dokumentet pasi që nuk i ka pa.

Përgjigje në pretendimin e dytë

Eksperti Shqyrtues sqaron se mos pranimi i referencave të dorëzuara nga OE ankues, të cilat referenca janë cekur më lartë dhe të cilat me të drejt nuk i ka pranuar autoriteti kontraktues nuk është në kundërshtim me nenin 59 të LPP-së. Andaj, pretendimi i OE ankues është i pa bazuar.

Lidhur me pretendimin e tretë të OE ankues NTGI "Grafo Loni" - Prishtinë se autoriteti kontraktues ka shkelur nenin 60 të LPP-së (Kriteret për Dhënien e Kontratës) duke e shpallur fitues një kompani me të shtrejt "kriteret e dhënies" operatori ekonomik i përgjegjshme me çmim me të ulët.

Përgjigje në pretendimin e tretë

Eksperti Shqyrtues sqaron se në aneksin 4 (Kriteret për Dhënien e Kontratës) të dosjes së tenderit, kriter për dhënien e kontrtatës ka qenë "çmimi më i ulët". Duke pasur parasysh që AK e ka eliminuar OE ankues për shkak të referencave, ndërsa i njëjti nuk ka bashkangjitur referenca të natyrës së ngjashme sikurse ka kërkuar AK, rezulton se AK ka vepruar konform nenit 60 të LPP-së pasi që neni 60, par. 1, nën par. 1.1 përcakton se autoriteti kontraktues do t'ia jap kontratën publike operatorit ekonomik që ka dorëzuar tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët. Ndërsa, OE ankues në mungesë të referencave të ngjashme, tenderi i tij

nuk mund të trajtohet si i përgjegjshëm konform dispozitës ligjore të cekur si më lartë. Pra, edhe ky pretendim ankimor është i pa bazuar.

8. MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Në bazë të sqarimeve të lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të refuzohet si e pa bazuar, ndërsa të vërtetohet njoftimi i AK-së për dhënie të kontratës.

Raporti i eksperizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues - Komuna e Skenderaj
- Panelit Shqyrtues - OSHP.
- OE ankues NTGI "Grafo Loni"-Prishtinë